



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Driton Hoxha" nr. 55, Lakrishte, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 500 400, Fax: + 383 (0)38 248 076, e-mail: info@pak-ks.org, ueb: www.pak-ks.org

Bazuar në Nenin 7 - paragrafin 1, Nenin 19 dhe 81 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Nenin 1, Nenin 4 - paragrafi 1, Nenin 6, të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, si dhe bazuar në publikimin e njoftimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me pengesat në qasje në SIMBNj për shkak të punimeve teknike të ASHI-së në TIK, si dhe duke u bazuar në ankesat e aplikantëve për pamundësinë në qasje në SIMBNj, Divizioni i Burimeve Njerëzore (DBNj) në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me datë 03 Dhjetor 2025, publikon këtë:

NJOFTIM PËR ANULIM


Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me datë 31 Tetor 2025, ka shpallur konkursin me nr. reference RN00018940 për pozitën ZYRTAR I LARTË I SHITJES DIREKTE (2 pozita) në AKP, me datë të fundit për aplikim 29 Nëntor 2025.

Procesi i aplikimit është realizuar, konform nenit 19 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përmes sistemit SIMBNJ, i cili garanton procedurë rekrutuese të hapur dhe konkurruese, me mundësi të barabarta dhe jo diskriminuese për të gjithë aplikuesit. Megjithatë, për shkak të punimeve të cilat janë zhvilluar në rrjetet softuerike, të cilat kanë qenë të publikuara edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme në media dhe rrjete sociale, aplikimi për një pjesë të kandidatëve ka qenë i pamundur.

Për shkaqet e lartcekura, Divizioni i Burimeve Njerëzore të AKP, del me njoftim për anulimin e procedurës së rekrutimit me nr. ref. RN00018940.

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur me këtë njoftim kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Prishtinë, 03 Dhjetor 2025


Fatos Meqa
Udhëheqës i Burimeve Njerëzore
Agjencia Kosovare e Privatizimit